



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org.	Nr. Prot:
Org. Jedinica 5	Prot. No: 3363
Org. Unit:	Data:
Nr. i faqeve	Datum: 26.09.2023
Br. stranica 2	
No. pages	
Prishtinë / Pristina	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 26/09/2023
Nr. 5/3363

Komisioni për licencimin e BPrAL / kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 5 me nr. protokolli 3363 të datës 18.09.2023, të parashtruar nga BPrAL - kolegji “ RIT – Kosovo (A.U.K)” për licencimin e programit sipas vendimit ref.585/23 të datës 2.05.2023 mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë -kolegji “ RIT – Kosovo (A.U.K)” për programin e studimit: “Informatikë dhe Teknologji Informative BSc 252 ECTS “ për periudhën trevjeçare (1 tetor 2023 deri me 30 shtator 2026) sipas vendimit ref.585/23 i datës 2.05.2023.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr.5, nr. protokolli 3363 të datës 18.09.2023, të parashtruar nga kolegji “RIT – Kosovo (A.U.K ”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë, zgjat tri vite akademike (01.09.2023 deri me 30 shtator 2026), sipas vendimit ref. 585/23 i datës 2.05.2023 nga Agjencioni i Kosovës për Akreditim.

Komisioni për licencim i MASHTI, duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSH;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit



Burim Gashi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Nr. 5-1910
Dt. 21.09.2022

Komisioni për licencimin e BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 5/1910 të datës 28.07.2022, të parashtruar nga BPrAL- Kolegji "RIT Kosovo (A.U.K) College, dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - Kolegji " RIT Kosovo (A.U. K) College " me seli në Prishtinë.
2. Licenca zgjatë nga 1 tetori 2022 e deri me 30 shtator 2025, për aq kohë sa institucioni ka akreditim sipas vendimit ref. 475/22 i datës 15.04.2022 nga Agjencioni për Akreditim i Kosovës.
3. Licenca për programin : Informatikë dhe Teknologji Informative BSc zgjatë nga 1 tetori 2020 deri me 31 shtator 2023 sipas vendimit nr. 1035/22 i datës 02.08.2022 i Agjencionit të Kosovës për Akreditim .
4. Licenca për programin: Studime Profesional, MSc 66 ECTS me specializim Parashikim Startegjik dhe Inovacion zgjatë nga 1 tetori 2022 deri me 30 shtator 2025, sipas vendimit nr. 1323/22 i datës 16.09.2022 oi Agjencionit të Kosovës për Akreditim.
5. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për Licencim të BPrAL, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 5/1910 i datës 28.07.2022 të parashtruar nga Kolegji " RIT Kosovo (A.U.K) College ", vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret sipas Ligjit të Arsimit të Lartë (Ligji Nr. 04/L-037 i datës 29 gusht 2011) dhe aktit nënligjor (U.A nr. 25/2012) për Licencimin e BPrAL.

Licenca e këtij Institucioni Privat të Arsimit të Lartë zgjatë tri vite akademike nga: 1 tetor 2022 deri me 30 shtator 2025 i mbështetur në vendimin e AKA i cekur në pikën 2.

Ndërkaq Programet e licencuara zgjasin sipas vendimeve të AKA-së të paraqitura në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi.

Komisioni për Licencim i MASHTI, duke marrë parasysh faktografinë dokumentuese materiale të këtij institucioni të parashtruara si aplikim për Licencim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi te Sekretari i Përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.



Kryetar i Komisionit

Burim Gashi